



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 191/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes posterit në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5350 (pesëmijë e treqind e pesdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 07.10.2013, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se me 06 tetor 2013, në ora 22:00, në rreth rrotullimin e rrugës “ Driton Islami ” në Ferizaj, subjekti politik PDK, ka vendosur posterin e kandidatit të tyre për kryetar komune të Ferizajt, Agim Aliu, në shenjen e komunikacionit, i cili veprim është në kundërshtim me ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP-së, neni 33 pika b .

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013, në ora 18:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën Anr. 191/2013 PZAP-i, te paraqitur nga subjekti politik LDK, ku ne përgjigjen ne ankesë subjekti politik PDK ne të cilën thekson se pretendimet e LDK-së, se janë të pa baza lidhur me shkeljen e nenit 33 pika a të LZP-së . Me tutje ka shtuar se aktivist të pa informuar e kanë bërë një veprim të tillë dhe menjëherë është intervenuar dhe është hequr fotografia e tille me simbolet e PDK-se dhe e gjithë kjo ka ndodhur për shkak te mos njohjes se rregullave zgjedhore. Gjithashtu në ankesë theksohet se individ të caktuar që nuk janë anëtarë të PDK-së,

po i keq shfrytëzojnë simbolet e PDK-së, duke i vendosur ato në vende të palejuara, me qëllim që ta dëmtojnë PDK-në, dhe se kemi intervenuar për të hequr simbolet tona.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si poster i kandidatit të PDK-së për kryetar komune të Ferizajt Agim Aliu është i vendosur në shenjat publike të trafikut, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik PDK, përveç thënieve se nuk kanë njohuri se kush e ka vendos posterin në fjalë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar, siç kërkohet nga dispozita e nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK, edhe më parë ka përsëritur shkeljen e natyrës së njëjtë duke e thyer kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

Anr. 191/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.